

DREJTËSIA

DITARI MUJOR

MANJA NË GREQI, VIZITON BURGUN E KORIDHIALOS

Gjatë një vizite dy ditore në Greqi, Ministri i Drejtësisë, z.Ulsi Manja ka bërë një vizitë në burgun grek të Koridhalos, shoqëruar nga Zv/Ministri grek i Mbrojtjes së Qytetarëve z. Lefteris Ikonomu. Manja është takuar me një përfaqësi të të dënuarve shqiptarë, mes të cilëve edhe gra, me të cilët u diskutua për kushtet dhe trajtimin e tyre në këtë burg. Pavarësisht problematikave, vullneti i përbashkët për mirëmenaxhimin e burgjeve dhe koordinimin e politikave penitenciare nuk mungon. Mes palëve është rënë dakort për një agjendë të përbashkët me programe edukimi dhe rehabilitimi për të burgosurit.

[LEXO PËR MË SHUMË](#)

- Manja takon homologun grek Kostas Tsiaras

Gjatë takimit, dy ministrat ishin në një mendim se me hapjen e negociatave nga ana e Shqipërisë, bashkëpunimi mes dy vendeve në fushën e drejtësisë do të marrë dimension të ri. Një erë e re do të nisë në fushën e shtetit të së drejtës dhe sundimit të ligjit, luftën kundër korrupsionit. Po ashtu, mes të dyve u fol për asistencë teknike në fushën e drejtësisë digjitale, si dhe për rritjen e nivelit të ekspertizës dhe përgatitjes edhe për ndihmësit ligjorë, këshilltarët ligjorë apo nëpunësit gjyqësorë.

[LEXO PËR MË SHUMË](#)

- Manja në Parlamentin grek dhe AKT

Gjatë vizitës së tij, Ministri shqiptar i Drejtësisë ka zhvilluar takime edhe në Parlamentin grek me Charalampos Athanasiou, Kryetar i Komisionit të Posaçëm të Përhershëm për Etikën Parlamentare, Athanasios Bouras, Kryetar i Komisionit të Posaçëm të Përhershëm për Institucionet dhe Transparencën dhe Maximos Charakopoulos, Kryetar i Komisionit të Përhershëm për Administratën Publike, Rendin Publik dhe Drejtësinë, ku është diskutuar forcimi i marrëdhënieve mes dy vendeve. Po ashtu, Manja ka vizituar edhe Autoritetin Kombëtar të Transparencës në Greqi, që është ekuivalentja e Drejtorisë së Përgjithshme kundër Korrupsionit. Gjatë takimit me drejtuesen e AKT Alexandra Rogkakou, është folur mbi mënyrat e hetimit dhe eksperiencat e veçanta, si dhe janë hedhur hapat e bashkëpunimit mes institucioneve homologe.

[LEXO PËR MË SHUMË](#)



NEGOCIATAT, PËRMBYLLET TAKIMI DYPALËSH KE-SHQIPËRI PËR KAPITULLIN 23

U përmbyll në Bruksel takimi dypalësh Komision Evropian – Shqipëri fokusuar në shqyrtimin analitik të Kapitullit 23 “Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore”, në kuadër të procesit të negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Delegacioni shqiptar kryesohej nga Ministri i Shtetit dhe Kryenegociator znj. Dhuka dhe përbëhej nga drejtues dhe përfaqësues të lartë të institucioneve kushtetuese dhe të krijuara me ligj të sistemit të drejtësisë, luftës kundër korrupsionit dhe të drejtave të njeriut. Institucionet e përfaqësuara në takim prezantuan përpara Komisionit Evropian shkallën e përafrimit të legjislacionit shqiptar me acquis e BE, kapacitetet administrative për garantimin e zbatimit me efektivitet të këtij legjislacioni në praktikë, si dhe planet e ardhshme për përafrim. Ministria e Drejtësisë në cilësinë e institucionit lider për Kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore” ka koordinuar këtë proces me një numër të madh institucionesh përgjegjëse, të cilat meritojnë falenderime të posaçme për përfaqësimin dinjtoz të delegacionit shqiptar në kuadër të këtij rrugëtimi kaq të rëndësishëm për vendin.

[LEXO PËR MË SHUMË](#)

VIZITË E DELEGACIONIT SHQIPËTAR NË KROACI



Në datat 8-9 nëntor 2022, u zhvillua në Kroaci një vizitë studimore me mbështetjen e Asistencës Teknike të Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri, për Koordinatorin Kombëtar Kundër Korrupsionit. Delegacioni Shqiptar, i kryesuar nga Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Drejtësisë dhe me përfaqësues nga sistemi i drejtësisë, u prit në këtë vizitë nga z. Nikola Grmoja, Kryetari i Këshillit Kombëtar për Monitorimin e Zbatimit të Strategjisë Kundër Korrupsionit në Kroaci.

[LEXO PËR MË SHUMË](#)

TIRANË, ZHVILLOHET MINISTERIALI “PËR DREJTËSINË DHE ÇËSHTJET E BRENDSHME”



Përgjatë dy ditëve është zhvilluar në Tiranë ministeriali "Për Drejtësinë dhe Çështjet e Brendshme". Dita e dytë i ka takuar Ministrisë së Drejtësisë si mikpritëse. Në fund të diskutimeve, komisioneri i BE Reynders, Ministri i Drejtësisë Çeke Blazek dhe Ministri shqiptar i Drejtësisë Manja dhanë një deklaratë për mediat, ku u nënvizua ecuria e Shqipërisë në kuadër të reformave, sidomos ato në Drejtësi, si mundësi e artë drejt integritimit. Përpjekjet dhe lufta e vazhdueshme kundër krimit dhe korrupsionit, si dhe ndihma që BE ofron në arritjen e rezultateve. Shqipëria konsiderohet si vend i besueshëm në luftën kundër krimit transnacional, ndërkohë që ka marrë edhe zotimin për kontribut për të asistuar prokurorin e Gjykatës Penale Ndërkombëtare dhe ekipin e ngritur në kuadër të EUROJUST për hetimin e krimeve në shkellje të së drejtës ndërkombëtare.

[LEXO PËR MË SHUMË](#)

KUKËS, INAGUROHET QENDRA E NJF

Ministri i Drejtësisë z.Ulsi Manja, i shoqëruar nga Kryetari i Bashkisë Kukës, zv.Ministri i Drejtësisë i Republikës së Kosovës dhe Drejtori i Përgjithshëm i Ndihmës Juridike Falas inaguroi Qendrën e re për ofrimin e shërbimit ligjor falas. Kjo qendër u krijua me ndihmën dhe bashkëpunimin e Partnerëve, UNDP dhe ADA. Ministri Ulsi Manja përgëzoi punonjësit e rinj të kësaj zyre dhe kërkoi prej tyre ofrim të një shërbimi cilësor dhe trajtim me dinjitet të çdo qytetari që do t'i drejtohet kësaj zyre për të marrë shërbime juridike. "Ofrimi i Ndihmës Juridike parësore falas do të mbështesë njerëzit në nevojë, të miturit me probleme sociale, jetimët, komunitetet egjiptiane dhe rome, viktimat e dhunës në familje apo viktimat të trafikut, etj, me qëllim që askush mos mbetet pa mbrojtje ligjore", tha Ministri Manja.

[LEXO PËR MË SHUMË](#)

BERAT, INAGUROHET ZYRA E RE E NJF

Së bashku me partnerët e UNDP dhe ADA, Ministri i Drejtësisë z.Ulsi Manja ka përfunduar zyrën e re të Ndihmës Juridike Falas në Berat. "Unë si Ministër Drejtësie, së bashku me partnerët tonë UNDP dhe Agjencinë Austriake për Zhvillim (ADA) e cila ka bërë të mundur këtë financim, kërkojmë të ndërtojmë një sistem të ri të ndihmës juridike falas, më efikas dhe më cilësor. Qëllimi jonë është të forcojmë kapacitetet profesionale të juristëve apo avokatëve, të cilët ofrojnë shërbimin e konsulencës ligjore pranë këtyre qendrave", u shpreh Ministri Manja. Ministri Manja gjatë fjalës së tij, theksoi se Organizatat Jofitimprurëse kanë një rol të rëndësishëm në rritjen e ndërgjegjësisë dhe edukimit ligjor.

[LEXO PËR MË SHUMË](#)

STRATEGJIA E DREJTËSISË PËR TË MITURIT, 2022-2026: MINISTRI MANJA NË NJË TAKIM KONSULTATIV ME PARTNERË STRATEGJIKË NDËRKOMBËTARË

U zhvillua takimi konsultativ për Strategjinë e Drejtësisë për të Miturit me Partnerët Ndërkombëtarë. Gjatë këtij takimi u shkëmbyen opinione mbi qëllimet kryesore të politikave të Planit të Veprimit, të Strategjisë së re të Drejtësisë për të Mitur, si dhe krijimin e një plani masash që ka në fokus programe informuese dhe edukuese për parandalimin e hershëm të kriminalitetit; hartimin e standardeve dhe udhëzuesve me praktikë më të mira për çështjet gjyqësore për të miturit; hartimin e raporteve të vlerësimit të legjislacionit penal, civil dhe familjar, me qëllim përmirësimin e legjislacionit në fushën e garantimit të të drejtave të fëmijëve në përpunje me standardet ndërkombëtare. Gjatë fjalës së tij, Ministri i Drejtësisë, z. Ulsi Manja tha ndër të tjera se "Strategjia e Drejtësisë për të Mitur 2022-2026, është konceptuar mbi katër qëllime politike, të cilat janë edhe fokusi për vitet në vijim. Ato janë parandalimi i krimeve ndaj fëmijëve dhe prej tyre mes edukimit, informimit dhe ndërgjegjësisë të shoqërisë dhe fëmijëve, një kuadër ligjor, institucional dhe profesionist që mundësojnë një drejtësi miqësore për çdo fëmijë, garantimi i qasjes në çdo kohë tek drejtësia miqësore për çdo fëmijë, si dhe drejtësi penale që mundëson parandalimin e ripërshtirjes së fëmijës në krim, rishoqërimin dhe riintegrimin e fëmijëve në kontakt/konflikt me ligjin". Mbrojtja dhe garantimi i të drejtave të fëmijëve është një ndër prioritetet kyçe të Ministrisë së Drejtësisë, e jetësuar në Programin e Qeverisë Shqiptare nën objektivin madhor: "Zbatimi i reformimit të sistemit të drejtësisë për të miturit në konflikt me ligjin, duke forcuar sistemin e drejtësisë restauruese dhe mbrojtjen efektive procedurale".

[LEXO PËR MË SHUMË](#)

TAKIM ME PARTNERËT VENDAS DHE NDËRKOMBËTAR MBI STRATEGJINË NDËRSEKTORIALE TË DREJTËSISË PËR TË MITUR 2022-2026 LIDHUR ME LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT



Ministri i Drejtësisë z.Manja, zhvilloi një takim pune me partnerët vendas dhe ndërkombëtar me qëllim konsultimin e paketës strategjike për drejtësinë për të mitur 2022-2026. Përmeshja me sukses e detyrimit për hartimin e kësaj Strategjie, do të shënojë disa arritje në drejtim të garantimit të aksesit të të miturve në drejtësi dhe procesit të rregullt ligjor për të miturit, parandalimit të ri-përshtirjes në krime të të miturve, rishoqërimin, riintegrimin dhe rehabilitimin e të miturve dhe forcimit të bashkëpunimit Ndërinstitucional midis institucioneve.

[LEXO PËR MË SHUMË](#)

15 OJF AUTORIZOHEN PËR SHËRBBIMET E NJF

Në Ministrinë e Drejtësisë është zhvilluar një ceremoni ku 15 Organizata Jofitimprurëse u autorizuan për dhënien e shërbimeve të Ndihmës Juridike Falas. Gjatë ceremonisë së shpërndarjes së autorizimeve, Ministri Manja shprehu angazhimin për vijimin e bashkëpunimit me këto organizata në kuadër të përmeshjes së misionit madhor "Garantimit të aksesit në drejtësi për të gjithë qytetarët". Tashmë organizatat jofitimprurëse të autorizuar ofrojnë shërbime të ndihmës juridike falas në Tiranë, Elbasan, Berat, Shkodër, Durrës dhe Vlorë, por synimi ynë është që të shtrihemi në të gjitha bashkitë dhe projektet më të mira të organizatave jofitimprurëse të mbështeten jo vetëm nga donatorët, por dhe nga buxheti i shtetit me fondin e vënë në dispozicion të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas. Ndihma juridike falas mbështet: shtresat në nevojë, rrit aksesin e qytetarëve në drejtësi, lehtëson punën e administratës publike dhe gjykatës.

[LEXO PËR MË SHUMË](#)

VLORË, HAPET DHOMA VENDORE E NDËRMJETËSIMIT

Në aktivitetin e zhvilluar me rastin e hapjes së Dhomës së Ndërmjetësisimit në Vlorë, ishte i pranishëm zv/Ministri i Drejtësisë z. Klajd Karameta, i cili foli për Rolin e Ndërmjetësit dhe mbështetjen e Ministrisë së Drejtësisë për këtë Profesion të ri. Nga ana e tij Ambasadori Austriak foli për mbështetjen që jep ADA në Sistemin e Drejtësisë e sidomos në këtë proces. Prefekti i Qarkut Vlorë përshëndeti të fuatit dhe Dhomën e Ndërmjetësisimit për këtë iniciativë ndërkohë në fund të aktivitetit, drejtuesja e Dhomës së Ndërmjetësive znj. Avdyli shpërndau certifikatat për Ndërmjetësit e Qarkut Vlorë. Aktiviteti u zhvillua në kuadër të projektit "Zgjerimi dhe Fuqizimi i Sistemit të Ndërmjetësisimit në Shqipëri", të cilin po e zbaton Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësive me dy partnerët tanë, CSSP dhe AFCR, i financuar nga "Agjencia Austriake për Zhvillim".

[LEXO PËR MË SHUMË](#)

50 APARATE OKSIGJENI DHURATË PËR IEVP-TË SHQIPTARË

Islamic Relief USA ka dhuruar për Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale të Shqipërisë 50 aparate oksigjeni me një vlerë të konsiderueshme monetare. Ministri i Drejtësisë z.Ulsi Manja, Drejtori i Islamic Relief për Shqipërinë Dr. Mohamed Soliman, si dhe Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve z.Admir Abrija kanë qenë të pranishëm në ceremoninë që u zhvillua me këtë rast. Aparatet e oksigjenit do të shpërndahen në IEVP-të e vendit, sipas një plani të përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve. Ministri i Drejtësisë ka inspektuar edhe laboratorin e analizave në spitalin e burgut të Tiranës.

[LEXO PËR MË SHUMË](#)

SHQIPËRI-KOSOVË, NËNSHKRUHEN DY MARRËVESHJE NË FUSHËN E DREJTËSISË

Ministri i Drejtësisë z. Ulsi Manja dhe homologa e tij e Kosovës znj. Albulena Haxhiu kanë nënshkruar dy marrëveshje në fushën e Drejtësisë. Angazhimi për firmosjen e tyre është marrë nga dy ministrat në mbledhjen e tetë të qeverive të Shqipërisë dhe Kosovës. "Marrëveshja për vendosjen e një bashkëpunimi të ndërsjelltë ndërmjet palëve në fushën e sistemit penitenciar" dhe "Marrëveshja për lehtësimin e bashkëpunimit të institucioneve në fushën e mbikëqyrjes së ekzekutimit të dënimeve alternative dhe lirimit me kusht", janë dy dokumentet e firmosur nga Manja dhe Haxhiu, të cilat duke u vënë shumë shpejt në zbatim do të sjellin lehtësira në adresë të qytetarëve të interesuar, si në Shqipëri dhe në Kosovë. Këto janë marrëveshje të arritura në vijim të një sërë angazhimesh, punësh e iniciativash të përbashkëta në fushën e drejtësisë nga institucionet dhe stafet respektive.

[LEXO PËR MË SHUMË](#)



Ministria e Drejtësisë
Ulsi Manja



ministra_drejttesisë
ulsimanja



@manja_uls